



MEMORADUM MIRËKUPITIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRMJET AMERICAN ADVISING CENTER DHE UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN

American Advising Center (AAC) dhe Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, të referuar së bashku këtu si "Partnerët" përmes këtij Memorandumi të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimi pajtohen që të krijojnë partneriteti bashkëpunimi për zhvillim të aktiviteteve për studentët e Universitetit të lartpërmendur, në mënyrë që të ofrojë informacion në lidhje me studimin në SHBA, këshillimin akademik për studentët që dëshirojnë të studiojnë në SHBA.

Në mënyrë specifike, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, do të ofrojë mbështetjen si në vijim:

1. Të bashkëpunoj me American Advising Center për shpërndarjen e materialeve informuese për studime në SHBA për studentët, profesorët dhe palët e interesuara.
2. Të ndihmoj stafin e American Advising Center në organizimin e dy prezantimeve dhe /ose sesioneve informuese për semestër për studentët në lidhje me Studimin në SHBA, mundësitë e bursave dhe testet Standardizuara TOEFL, SAT, GRE DHE GMAT.
3. Të caktojë një person kontaktues përbrenda Universitetit që do të shërbej si ndërlidhje në mes të American Advising Center dhe Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Në mënyrë specifike, American Advising Center do të ofrojë mbështetjen si në vijim:

1. Të ofrojë, kur janë të disponueshëm, publikimet për studime në SHBA, dhe materiale të tjera për studim në SHBA për studentët dhe të gjithë ata që janë të interesuar për studime në SHBA, me bursa.
2. Të ofrojë prezantime dhe sesione informuese mbi studimet në SHBA, bursat akademike dhe testet standardizuese TOEFL, GRE dhe GMAT në institucionin tuaj.
4. Të ofrojë këshillime dhe udhëzime të përgjithëshme dhe pa pagesë rreth universiteteve dhe procedurave për të studiuar në SHBA, për studentët e institucionit tuaj.



Mosrespektimi i Marrëveshjes

Partnerët kanë të drejtën që të vlerësojnë nëse ndonjë pjesë të kësaj marrëveshje nuk është respektuar. Nëse konstatohet që partnerët nuk kanë respektuar kushtet e kësaj marrëveshje, zotëron të drejtën për të thirrur Partnerët në takim për rivlerësimin e kushteve të kësaj marrëveshje apo për ndërmarrjen e masave të tjera që i vlerëson si të nevojshme për të garantuar pajtueshmërinë.

Periudha Kohore

Shkurt 2024 – Shkurt 2025 – një vit me mundësi vazhdimi.

Nënshkrimet

Palët si më poshtë kanë ekzekutuar këtë Marrëveshje Mirëkuptimi me 22.01.2024

Për American Advising Center:



Rrezarta Fondaj

Për Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti":


Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani, Rektor

